

FATMIR TOÇI

ARBËRESHËT

MIDIS REALITETIT DHE MITIT

Vështrim i shkurtër historiko-kulturor

BOTIMET TOENA

FATMIR TOÇI

ARBËRESHËT
MIDIS REALITETIT DHE MITIT
Vështrim i shkurtër historiko-kulturor

monografi

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2021

Botuese: Irena Toçi

Recensentë: Akademik Rexhep Qosja, prof. dr. Francesco Altimari, prof. dr. Matteo Mandalà, prof. dr. Pëllumb Xhufi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktorë shkencorë: Akademik Gjovalin Shkurtaj, prof. dr. Rami Memushaj

Korrektore letrare: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

Hartografia: Amanda Hiller, Emanuele Romata

Fotografitë: Autori, Amanda Hiller, Laerta Toçi

ISBN: 978-9928-327-94-9

@ Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

*Kujtimet të prindërve të mi,
që më mëkuan me dashurinë për vendin
dhe për historinë e tij të lashtë e të re.*

Vendosja e arbëreshëve në krahinat italiane nga fillimi i shek. XV deri më sot



- Qendra e Krahinës
- Ngulime arbëreshe sot
- Ngulime me gjurmë arbëreshe
- Ngulime emigratore arbëreshe pas Luftës II Botërore

PASQYRA E LËNDËS

PARATHËNIE.....	11
-----------------	----

PJESA E PARË

ARBËRESHËT - NJË HISTORI MBIJETESE.....	17
--	-----------

Marrëdhëniet midis popujve të brigjeve të Adriatikut e Jonit para shek. XV.....	20
Historia e familjes “Durazzo” - nga emigrantë në kryeministra të Gjenovës.....	26
Turqit osmanë në Arbëri dhe familja Kastrioti.....	28
Marrëdhëniet e Skënderbeut me Vatikanin, Venedikun dhe Mbretërinë e Napolit.....	32
Skënderbeu në Itali si strateg dhe diplomat.....	37
Prania dhe ngulimet e para arbëreshe në Itali në shek. XIII-XV...49	
Valët e mërgimit masiv në Itali në shek. XV. Krijimi i ngulimeve arbëreshe.....	65
Kastriotët dhe familjet e mëdha arbëre në mërgim.....	92
Arbëreshët, luftëtarë në vendin e tyre, stratiotë në dhe të huaj...109	
Mënyra arbëreshe e jetesës, kultura, traditat dhe zakonet e tyre...119	
Roli i kishës në ruajtjen e identitetit arbëresh.....	123
Komunitetet që kaluan nga riti bizantin në ritin latin në shek. XVII.....	129
Familja Albani në Urbino dhe papa shqiptar Klementi XI (Albani).....	133
Gjuha arbëreshe, arsimi, kolegjet dhe seminarët arbëreshe në Kalabri e Sicili në shek. XVIII.....	140
Letërsia arbëreshe para dhe pas periudhës së Rilindjes.....	159
Shkrimtarë të shquar arbëreshë.....	169

Jeronim de Rada - jeta, vepra dhe kongreset gjuhësore arbëreshe.....	170
Lëvizja e intelektualëve arbëreshë për pavarësinë e Shqipërisë..	181
Arbëreshët në historinë e re të Italisë.....	190
Rreziku i asimilimit dhe i humbjes së identitetit arbëresh.....	201

PJESA E DYTË

NGULIMET ARBËRESHE.....	207
--------------------------------	------------

KREU I: NGULIMET ARBËRESHE SIPAS KRAHINAVE

TË ITALISË.....	207
1. Krahina e Abrucos (Regione Abruzzo).....	209
2. Krahina e Bazilikatës (Regione Basilicata).....	214
3. Krahina e Emilia Romanjës (Regione Emilia Romagna).....	221
4. Krahina e Kalabrisë (Regione Calabria).....	223
5. Krahina e Kampanies (Regione Campania).....	245
6. Krahina e Lacios (Regione Lazio).....	251
7. Krahina e Liguries (Regione Liguria).....	257
8. Krahina e Lombardisë (Regione Lombardia).....	265
9. Krahina e Markes (Regione Marche).....	268
10. Krahina e Molizes (Regione Molise).....	278
11. Krahina e Piemontit (Regione Piemonte).....	290
12. Krahina e Pulies (Regione Puglia).....	295
13. Krahina e Sardenjës (Regione Sardegna).....	336
14. Krahina e Sicilisë (Regione Siciliana).....	349
15. Krahina e Toskanës (Regione Toscana).....	364
16. Krahina e Umbries (Regione Umbria).....	370
17. Krahina e Venetos (Regione del Veneto).....	378

KREU II: NDARJA KISHTARE: KISHA BIZANTINE

ARBËRESHE.....	385
Kisha bizantine Arbëreshe.....	387
Eparkia e Ungrës (Eparchia di Lungro).....	395
Eparkia e Horës së Arbëreshëvet (Eparchia di Piana degli Albanesi).....	399

KREU III: PASQYRAT PËRMBLEDHËSE.....403

Tabela 1. Lista e plotë e vendbanimeve arbëreshe në Itali.....	405
Tabela 2. Emigracioni arbëresh në Itali në shek. XII-XVIII sipas rendit kronologjik.....	420
Tabela 3. Imigracioni arbëresh (emigracioni i brendshëm) në Itali në fillim të shek. XVI - fundi i shek. XVII.....	428
Tabela 4. Famullitë dhe kishat e ritit bizantin në eparkinë e Ungrës në Kalabri.....	430
Tabela 5. Famullitë dhe kishat e ritit bizantin në eparkinë e Horës së Arbëreshëvet në Sicili.....	433
Tabela 6. Komunitetet arbëreshe që kanë kaluar nga riti bizantin në ritin latin.....	434
Bashkësitë arbërishtfolëse të Italisë.....	436
Bibliografia.....	441
Uebografia.....	461
Treguesi i emrave.....	467
Treguesi i emrave të vendeve.....	473

PARATHËNIE

Jeta e arbëreshëve të Italisë është histori e qëndresës dhe e mbijetesës së tyre në rrjedhë të shekujve, duke na sjellë sot, në kohët moderne, të gjallë e të freskët gjuhën arbëreshe, kulturën, doket e zakonet, si dhe besimin e krishterë të ritit bizantin etj., si pasuri e çmuar shpirtërore dhe si shprehje e spikatur e identitetit të tyre në një botë që po shkon me shpejtësi drejt globalizimit dhe rrafshimit të veçorive kulturore të pakicave.

Të njohim arbëreshët, do të thotë të mësojmë për kalvarin e vuajtjeve dhe odisenë e shpërnguljes së tyre përtej brigjeve të Adriatikut e Jonit, në një vend të huaj me gjuhë e zakone të ndryshme, në fillim krejt të panjohura; për rreziqet e shumta që kanë kaluar në përballjen me elementet e natyrës dhe me vendësit; për përpjekjet e tyre për t'u përshtatur me mjedisin shoqëror në atdheun e ri; për ngulimet në tërësinë e tyre dhe për ato që u mbijetuan furtunave të kohës; për gjendjen e tyre aktuale ekonomike, kulturore, arsimore etj.

Libri “Arbëreshët midis realitetit dhe mitit”, që po i jepet në dorë lexuesit, është një punim me karakter informues që synon të hedhë dritë mbi çështjet e mësipërme. Në të trajtohen, në një vështrim përmbledhës e të përgjithshëm, historia mbi pesëqindvjeçare e arbëreshëve në aspektet e saj kryesore, duke nisur nga aventura tragjike e kalimit të tyre nga Arbëria drejt Italisë e deri në ditët tona, shpërndarja e ngulimeve arbëreshe dhe konstitucioni fetar i tyre. Për hartimin e tij kam shfrytëzuar botime historiografike të derisotme nga autorë shqiptarë dhe të huaj, ku burimet arbëreshe zënë një vend të rëndësishëm; botime informative, guida kulturore e turistike të komunave arbëreshe; monografi tematike për ngjarje, vende, çështje e figura të komuniteteve të veçanta; informacione që vijnë nga faqet zyrtare të uebit të komunave të ndryshme etj.

Një material shumë të vlefshëm kam mbledhur edhe në ngulimet arbëreshe nga kontaktet e drejtpërdrejta me intelektualë dhe njerëz të thjeshtë të këtyre ngulimeve. Mendoj se jam nga shqiptarët e paktë, në mos i vetmi, që ka mundur të shkelë e të shohë nga afër pothuaj të gjitha vendbanimet arbëreshe në Itali, jo vetëm ato që njihen sot edhe zyrtarisht si të tilla (rreth 50 komuna e fraksione të tyre), po mbi 530 qendra banimi që ishin arbëreshe, një pjesë e tyre, deri edhe një shekull më parë, por që janë përzier, asimiluar ose larguar drejt qendrave të tjera për arsye nga më të ndryshmet, duke mbetur, gjithsesi, pjesë e historisë dhe e kulturës së vendit ku ata jetuan. Kjo u bë e mundur gjatë angazhimit tim politik si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, kur u mbështet kërkesa që Kuvendi të kishte një strukturë të përhershme për marrëdhëniet me arbëreshët. Lindi kështu grupi kuvendor i përbërë nga pesë deputetë për marrëdhëniet me arbëreshët e Italisë, si shprehje e vlerësimit të lartë për historinë dhe kulturën e pasur të shqiptarëve matanë detit dhe për kontributin e tyre të madh në kulturën dhe historinë tonë kombëtare. Edhe pse disa prej komunave arbëreshe në Kalabri e Sicili i kisha vizituar që pas viteve '90 të shekullit të kaluar, të qenit në krye të këtij grupi kuvendor më mundësoi të udhëtoja disa dhjetëra herë në të gjithë Italinë, të njihem nga afër me jetën e zakonet e arbëreshëve, të merrja pjesë në takime, veprimtari kulturore e festa.

Për hartimin e librit u detyrohem shumë një numri të madh personash që më kanë ndihmuar në mbledhjen e lëndës për hartimin e monografisë me qëllim botimin e këtij libri. Në radhë të parë, falënderoj të gjithë ata që më kanë shoqëruar në udhëtimet e mia në ngulimet arbëreshe të Italisë, nga Sicilia në Torino, duke më krijuar kushtet për t'i vizituar. Ata janë aq shumë, kryetarë komunash e intelektualë arbëreshë, sa nuk mund t'i përmend të gjithë me emër. Së dyti, sjellja e librit në formën përfundimtare u detyrohet vërejtjeve e këshillave

të recensentëve, akademikëve Rexhep Qosja, Pëllumb Xhufi, Francesco Altimari dhe Matteo Mandalà, të cilët gjetën kohë për ta lexuar me vëmendje materialin; u detyrohet, gjithashtu, redaktorëve, prof. dr. Rami Memushajt, që e ka lexuar disa herë materialin, duke lëmuar frazën dhe duke verifikuar e saktësuar çdo gjë të dyshimtë, dhe akademikut Gjovalin Shkurtaj, njohës i mirë i botës arbëreshe dhe dashamirës ndaj punës sonë modeste.

Falënderoj miqtë e mi Amanda Hiller dhe Emanuele Romata, që banojnë në Xhinoza Marina të Tarantos në Itali, për pasionin e tyre për historinë dhe kulturën arbëreshe, si dhe për sugjerimet e tyre, hartografinë, dhe një pjesë të fotografive të këtij libri.

E vyer, si gjithmonë, si dhe për çdo libër tjetër që del nga Shtëpia Botuese “Toena”, ka qenë puna e trupës së saj, në mënyrë të veçantë: asistentes sime Aurora Kënga dhe puna redaktuese e Sonila Kapos dhe vajzës sime, Majlinda.

Së fundi, u detyrohem shumë bashkëshortes sime, Irenës, dhe familjes sime të madhe, që përballuan mungesat e mia gjatë endjeve më shumë se 10-vjeçare për mbledhjen e studimin e materialeve dhe 3 vjetëve që m’u deshën për shkrimin e librit, duke më nxitur për ta çuar deri në fund punën, saqë mund të them pa e tepruar se janë ato që ma “dhuruan” këtë libër.

Libri është i ndarë në dy pjesë krerë. Në pjesën e parë, që përbën pjesën themelore të tij, trajtohet historia emigruese e arbëreshëve, vuajtjet dhe përpjekjet e tyre për t’u natyralizuar në Atdheun e ri; gjendja politike, shoqërore, ekonomike e kulturore që nga koha kur u mërguan e deri sot; roli i Skënderbeut në marrëdhëniet me shtetet italiane të kohës dhe figura frymëzuese të tij pas vdekjes për mbajtjen gjallë të krenarisë dhe të identitetit të vendit të origjinës; fati i familjeve të mëdha shqiptare në mërgim dhe roli mbresëlënës i arbërve stratiotë në dhe të huaj; mënyra arbëreshe e jetesës, kultura, traditat dhe zakonet e tyre; roli i kishës në ruajtjen e identitetit arbëresh;

përpyjekjet për ruajtjen e gjuhës arbëreshe, për arsimimin dhe për lëvrimin e letërsisë së shkruar para dhe pas periudhës së Rilindjes; roli aktiv i Arbëreshëve në të gjitha etapat e historinë së re të Italisë; kontributi i intelektualëve arbëreshë për Pavarësinë e Shqipërisë; si dhe rreziku, në ditët tona, i asimilimit dhe i humbjes së identitetit arbëresh dhe masat që mund të ndërmerren për t'i bërë ballë këtij rreziku, duke forcuar lidhjet ekonomike, kulturore e arsimore me botën arbëreshe.

Pjesa e dytë të librit ndahet në disa krerë. Me qëllim që të jepet një tablo e shpërndarjes së arbëreshëve në të gjithë Italinë, në kreun e parë është trajtuar në mënyrë të përmblendhur prania e ngulimeve arbëreshe në 17 krahina të Italisë së sotme nga 20 të tilla gjithësej, ilustruar me hartën përkatëse për secilën krahinë.

Një krye i veçantë i është kushtuar ndarjes kishtare, institucioneve fetare, rolit të kishës së ritit bizantin për ruajtjen e identitetit arbëresh dhe organizimit të kishave të ritit bizantin në dy dioqeza: të Ungrës (Lungro) në Kalabri për kishat e ritit bizantin të Italisë kontinentale dhe të Horës së Arbëreshëve (Piana degli Albanesi), për ishullin e Sicilisë.

Në kreun e fundit të librit, janë dhënë në 6 tabela përmblendhëse, lista e plotë e 534 vendbanimeve arbëreshe në Itali, datat e emigrimit të arbëreshëve në Itali në shek. XII-XVIII dhe të imigrimit (lëvizjes brenda Italisë) nga fillimi i shek. XVI deri në fund të shek. XVII, lista e famullive dhe e kishave të ritit bizantin në Eparkinë e Ungrës dhe të Horës së Arbëreshëve dhe lista e ngulimeve arbëreshe që kanë kaluar në ritin latin.

Në fund të librit jepet një bibliografi e pasur me veprat e burimet që kemi mundur të shfrytëzojmë, e cila mund të shërbejë për të ndihmuar e orientuar të gjithë ata që duan të mësojnë më shumë e të thellohen në njohjen e të gjitha aspekteve të jetës së arbëreshëve, të cilat nuk mund të ishin objekt i këtij botimi.

Libri është i pajisur edhe me treguesin e emrave të përveçëm të njerëzve dhe të vendeve.

Do të ndihesha shumë i lumtur nëse kjo përpjekje modeste imja do ta ndihmonte sadopak lexuesin të njohë më gjerë arbëreshët e Italisë dhe do t'i shërbente si një shtysë për ta prekur nga afër botën arbëreshe, si dhe për të forcuar lidhjet në të gjitha fushat me këtë degë të trungut amë.

Autori

PJESA E PARË
ARBËRESHËT,
NJË HISTORI MBIJETESE

Jeta e arbëreshëve të Italisë përbën një kohë historike dhe etnokulturore të rrallë në historinë evropiane, që ka nisur qysh nga fundi i mesjetës dhe që vijon deri më sot. Rrethanat historike që kanë çuar në dyndjen e një pjese të madhe të kombit tonë drejt së panjohurës, kanë qenë politike, ekonomike dhe fetare: përpjekje për t'i shpëtuar nënshtrimit dhe represionit të pushtuesve osmanë dhe vuajtjeve e vështirësive në kufijtë e mbijetesës në Dheun e tyre. Ngulimet e tyre në Itali në zona e vende të braktisura e në marrëdhënie të kufizuara me vendësit, si dhe mungesa e studimeve të plota e të thelluara kanë bërë që historinë e arbëreshëve ta gjejmë rëndom të veshur me mite e legjenda, të cilat, edhe pse të bukura, nuk arrijnë të zbulojnë realitetin e dhimbshëm të një populli në mërgim.

Kërkimet në arkivat e Vatikanit, Venedikut, Barcelonës etj., por mbi të gjitha në ato të Napolit, si qendër e mbretërisë në Italinë e Jugut për disa shekuj (Archivio di Stato di Napoli, Biblioteca Nazionale di Napoli), dhe një sërë botimesh në dy shekujt e fundit nga studiues të njohur, si Pietro Pompilio Rodotà, Gennaro Maria Monti, Francisc Pall, Gaetano Petrotta, Paolo Petta, Salvatore Bugliaro, Italo Sarro etj. etj., kanë hedhur dritë dhe kanë saktësuar ngjarje e data për një periudhë të trazuar të Italisë në mesin e mijëvjeçarit të dytë; po ashtu, në fundin e shekullit të kaluar dhe në këta dy dhjetëvjeçarët e shekullit të ri, ka një intensifikim të punës kërkimore-studimore, në qendër të së cilës janë katedrat e albanologjisë në Universitetet e Kozencës dhe të Palermos etj., me emra të tillë studiuesish të përkushtuar, si Francesco Solano, Antonino Guzzetta, Italo Fortino, Françesko Altimari, Matteo Mandalà, Italo Sarro etj. Nëpërmjet tyre del qartë dhe i dokumentuar historiku i pranisë, rolit dhe i rëndësisë së faktorit arbëresh në jetën politiko-shoqërore dhe ekonomike të Italisë, kryesisht të jugut të saj, që para shek. XV e deri në ditët tona.

Ky libër që po i jepet në dorë lexuesit, është një përpjekje modeste jona për të dhënë një përmbledhje të sintetizuar të historisë së “mrekullisë arbëreshe”, të ngulimeve dhe të përpjekjeve të tyre për t’u përshtatur në mjedisin e ri e të ndryshëm italian, me të cilin dallimet ishin të thella për nga gjuha, kultura, mënyra e jetesës, ritet, praktikimi i besimit fetar etj.

Marrëdhëniet midis popujve të brigjeve të Adriatikut e Jonit para shek. XV

Shpërnguljet dhe lëvizjet e popujve përgjatë shekujve nga njëri vend në tjetrin, në grupe të mëdha apo në bashkësi më të vogla dhe etnikisht kompakte, ka qenë një dukuri e zakonshme dhe e përhershme që nga lashtësia e deri në kohën tonë. Arsyet kryesore të këtyre lëvizjeve kanë qenë luftërat dhe konfliktet për dominim mbi të tjerët, vendosja në vende me kushte më të mira e të sigurta jetese, sëmundjet, epidemitë dhe fatkeqësitë e shpeshta natyrore etj. Shkuarja drejt së panjohurës, në territore e në marrëdhënie me popuj të tjerë, të ndryshëm për nga etnia e kultura e formimit dhe e jetesës, me shpresën për një jetë më të mirë, është shoqëruar gjithmonë me mundime e humbje tragjike njerëzore e materiale. Në kontaktet me popullsinë indigjene, në pak kohë apo pas periudhash më të gjata, pjesa më e madhe e këtyre etnive ose komuniteteve në lëvizje janë asimiluar e zhdukur, po duke lënë, gjithsesi, gjurmë të pranishme të tyre në historinë dhe në kulturën e vendeve ku u vendosën. Megjithatë, ka pasur edhe raste kur ka ndodhur e kundërta, kur popullsitë që janë zhvendosur kanë qenë të mëdha ose janë vendosur në vende të pabanuara më parë dhe kanë qenë ato që u janë imponuar vendësve me identitetin, gjuhën dhe kulturën e tyre. Kështu, përgjatë shekujve, që nga dëshmitë e para të shoqërisë njerëzore, të paktën që nga koha e shumerëve në Mesopotaminë e lashtë (mijëvjeçari V p.K), të parët që përdorën shkrimin kunjor, kanë lulëzuar qytetërime e kultura, gjuhë e besime të

ndryshme e të shumta, të cilat sot nuk ekzistojnë më, për shkak se janë asimiluar nga popuj me identitet “më të fortë” ose janë zhvilluar e transformuar në kushtet e reja historike.

Kjo paradigmë lëvizjesh e kontaktesh është e vërtetë edhe për popujt e Ballkanit dhe të gadishullit Apenin, në anën tjetër të Adriatikut. Historia e këtyre popujve është që nga lashtësia një histori lidhjesh të pandërprera politike, ekonomike, kulturore e fetare, shkëmbimesh tregtare, luftërash e lëvizjesh demografike. Kështu, në bregdetin lindor të Adriatikut dhe të Jonit, gjatë shek. VII-VI p.K., që ishin koha e lulëzimit të Greqisë së lashtë, u themeluan kolonitë greke të Apolonisë, Durrësit (Epidamnos, më vonë Dyrrachion), Orikumit (Orikon), Raguzës (Epidauros) etj. Të tilla koloni ishin ngritur në shek. VIII-VII p.K. nga popullsi jonike e dorike të Greqisë së Lashtë. Koloni të shumta greke u themeluan në vitet 387-385 p.K. nga tirani i Sirakuzës, Dionisi i Madh, i përfshirë në atë periudhë në luftërat punike kundër Kartagjenës. Të tilla ishin Tarantoja (Taras), Sibari (Sybaris), Napoli (Parthênopoe, më pas Neapolis) etj.¹, që u quajtën “Magna Grecia”, si dhe qytete të tjera në krahinat jugore të Kalabrisë, Kampanies, Bazilikatës dhe Pulies. Këto koloni në të dy brigjet e Adriatikut e Jonit e bënë detin një udhë kryesore komunikimi të lëvizjes së njerëzve, të ushtrive dhe të shkëmbimit të mallrave. Pas inkursioneve dhe betejave të Pirros së Epirit në Italinë e Jugut (kryesisht në Taranto dhe në Sicili, 280-275 p.K.) dhe pushtimit romak të Ilirisë e Greqisë (280-146 p.K., kur u pushtua dhe u shkatërrua Korinti), këto dy dete shërbyen si një urë kalimi e mbingarkuar, që lidhte zotërimet perëndimore dhe lindore të Perandorisë Romake, dhe të tillë mbetën deri në vitin 395, kur ajo u nda në dy pjesë: në Perandorinë e Perëndimit, me qendër në Romë, dhe në atë të Lindjes, me qendër në Kostandinopojë.

¹ https://it.wikipedia.org/wiki/Magna_Grecia#Colonie_greche_in_Italia_non_appartenenti_alla_Magna_Grecia.

Perandoria e Lindjes, e quajtur “bizantine”, që jetoi për gati 11 shekuj, qe një amalgamë popujsh e racash, e shtrirë në territore të mëdha në tri kontinente: Evropë, Azi dhe Afrikë. Trevat e Arbërisë, duke u ndodhur në skajin perëndimor të Bizantit dhe në kufirin midis dy perandorive, vijuan të mbeteshin rrugë kalimi, lëvizjesh e marrëdhëniesh midis Lindjes e Perëndimit. Historia e Perandorisë Bizantine është histori e luftërave të pareshtura kundër saj nga të gjitha anët: luftërat e brendshme për pushtet dhe nga provincat që e përbënin, sulmet e mongolëve dhe të fiseve turke në Lindje, si dhe ndërmarrjet luftarake të shteteve dhe të principatave evropiane nga Perëndimi, të cilat përdornin portet pulieze e kalabreze dhe ato përballë Arbërisë e Greqisë në Adriatik e Jon për të shkuar drejt Kostandinopojës. Të tilla ishin inkursionet normane të viteve 1081-1185 të Robert Guiskardit e më pas të birit të tij Boemundit, që vijuan me pushtimet në Greqi nga Ruxheri II e u shuan me mundjen në luftën e Selanikut (1185) të Gulielmit II, mbretit të Sicilisë, nga ushtria bizantine. Kësaj periudhe i përket dokumentimi i parë i pranisë së një kolonie shqiptare në qytetin e Brindizit (1199, kur famullitari i shqiptarëve në këtë qytet i shkruante papës Inocenti III², si ndërmjetës në komunikimin me mbretin e Bullgarisë. Më pas, gjendet një dokument i vitit 1272 që bën fjalë për një koloni shqiptarësh në lokalitetin e quajtur Pallavirgata, pranë Brindizit, si dhe disa në qytete të tjera të provincës, për të cilat tashmë është humbur çdo gjurmë³, që tregon se ky komunitet shqiptarësh ishte aty para këtij viti.

Pas më shumë se një shekulli normanët u larguan nga territoret ballkanike të pushtuara prej tyre, përfshirë Vlorën, Durrësin, Janinën, Korfuzin etj. Vendin e tyre në vitet e para

² *Roma e l'Oriente: rivista criptoferratense per l'unione delle chiese*, f. 137; (<https://books.google.it/books?id=KSPGWwHSNr8C&hl=it&pg=PA137#v=onepage&q&f=false>).

³ Archivio storico italiano, Quarta Serie, Tomo VI, Vieusseux, Firenze, 1880, f. 112; https://archive.org/details/s3_archivio_storico_i_06_depuuoft/page/112).

të shek. XIII, pas Kryqëzatës IV, që synonte çlirimin e “Tokës së Shenjtë” nga kurdët (islamikët) dhe që solli krijimin jetëshkurtër të Perandorisë Latine (Romake) të Lindjes (1204), e zunë formimi i një sërë principatash latine në jug të Ballkanit, midis të cilave edhe Despotati i Epirit, dhe dominimi i Venedikut në bregdetin lindor të Mesdheut. Edhe pse pas gjysmë shekulli rikthehet Perandoria Bizantine, pas betejës së Pelagonisë në vitin 1259, dhe asaj të Kostandinopojës më 1261, territori bregdetar i Arbërisë, Vlora, Durrësi, Butrinti, si dhe ishulli i Korfuzit, mbetën të pushtuar nga mbreti i Sicilisë, Manfredi i suevëve. Por vetëm për pak kohë, sepse, pas humbjes dhe vdekjes së tij në betejën e Beneventos (1266)⁴, mbretëria e Sicilisë kaloi në duart e anzhuinëve, që kishin edhe mbështetjen dhe bekimin e Papës Urbani IV. Vetëm tre vjet më vonë, mbreti i ri, Karli, nuk e la pas dore pjesën bregdetare përballë, por zbarkoi në Durrës dhe në thellësi të territorit (1269), duke marrë kurorën e “Mbretërisë së Arbrit” (Regnum Albaniae, 1272)⁵, të cilën e krijoi vetë, duke shfrytëzuar grindjet midis feudalëve shqiptarë dhe pasigurinë e tyre ndaj kërcënimit të fqinjëve.

Aventura anzhuine për më shumë se një shekull në Arbëri është një histori pakënaqësish, konfliktesh e luftërash të vazhdueshme, zgjerimesh e ngushtimesh të territoreve me qendër Durrësin, me synim kalimin drejt Kostandinopojës për kurorën e Perandorisë Bizantine. Po kjo ëndërr mbeti e papërmbushur edhe për shkak të revoltave brenda Mbretërisë së Napolit, si ajo e Palermos në vitin 1282⁶, ku francezët u përzunë nga ishulli, duke i hapur rrugën dinastisë spanjolle aragoneze me kurorëzimin e Pjetrit III, i njohur edhe si Pjetri I, si mbret i Sicilisë.

⁴ Federico Canaccini, *1268 La battaglia di Tagliacozzo*, Gius Laterza & figli, Bari, 2019, f. 10.

⁵ Etleva Lala, *Regnum Albaniae, the Papal Curia and the Western Visions of a Border line Nobility*, Central European University - Department of Medieval Studies, Budapest, 2008, f. 12.

⁶ Francesco Paolo Tocco, *Il regno di Sicilia tra Angioini e Aragonesi*, Monduzzi, Bologna, 2008, f. 17.

Në bregun përkundrejt kjo ishte periudha e ekspansionit të Mbretërisë Serbe ndaj vendeve të tjera ballkanike, e cila në vitet '30 të shek. XIV kishte pushtuar Bosnjën, Maqedoninë, Epirin, me përjashtim të Durrësit, që zotërohej nga anzhuinët e Mbretërisë së Napolit, nën drejtimin e Tanush Topisë.

Shtypja e pamëshirshme e pushtetit serb dhe bizantin mbi popullsinë ballkanase, veçanërisht mbi shqiptarët, nxiti në vitet 1328-1333 revolta popullore me fisnikët shqiptarë në krye, të cilët kishin humbur të drejtat e tyre mbi pasuritë dhe pronën. Në shumë raste ata rrethuan kështjellat e garnizonet e pushtueseve, duke i përzënë serbët e bizantinët nga një pjesë e madhe e tokave të Arbrit. Por kundërpërgjigjja e Bizantit që e pamëshirshme. Vetë perandori bizantin Androniku III Paleolog, në bashkëpunim me serbët e Stefan Dushanit, ndërmori në vitin 1336 një fushatë ushtarake për shtypjen e kryengritjeve në Vlorë, Berat, Skrapar, Ohër, Devoll, Kolonjë, Këlcyre etj., duke vrarë çdokënd e duke plaçkitur çdo gjë që gjeti përpara.

Zgjedha e rëndë e serbëve do të vazhdonte deri në vitin 1355 kur, pas vdekjes së Stefan Dushanit, Krajlit të Sërbisë, perandoria e e tij do të coptohej në principata të vogla nga feudalët vendas⁷. Një prej tyre, Balsha I, kryezoti i Shkodrës, i shtriu zotërimet e tij përtej Drint në gjithë Veriun, përfshi Malin e Zi, në territore të zaptuara nga serbët që nga viti 640⁸. I biri, Gjergji I Balsha, e shtriu sundimin e tij në tërë Gegërinë e Toskërinë, Malin e Zi, një pjesë të Bosnjes dhe të Hercegovinës, gjysmën e Dalmacisë dhe në pjesë të madhe të Maqedonisë. Noli thekson se ai ishte fitimtar në të gjitha betejat me serbët, boshnjakët, napolitanët dhe turqit, derisa vdiq në vitin 1379. Edhe në Jug prijësi çam Gjin Bue Shpata e ruajti të pavarur despotatin e tij derisa ndërroi jetë në vitin 1400. Ishte koha e

⁷ Noli S. Fan, *Historia e Skënderbeut, Kryezotit të Arbërisë*, Shtëpia Botonjese Naim Frashëri, Tiranë, 1973, fq. 6

⁸ *Po aty*, fq. 6

zgjerimit të shqiptarëve, nënvizon Noli në librin e tij “Historia e Skënderbeut”⁹ për këtë periudhë, që më pas do të ndryshonte për shkak të mosbashkëveprimit të principatave shqiptare, të cilat me përçarjen midis tyre ranë prë e dominimeve të “turqëve nga Lindja, serbëve dhe boshnjakëve nga Veriu, venecianëve nga Perendimi dhe napolitanëve nga Jugu”.

Të gjitha këto trazira të pareshtura gati dymijëvjeçare nuk mund të mos kishin pasoja të rënda për popullsinë e vendeve të bëra shesh lufte, e cila, për të shpëtuar nga dhuna e egër e pushtuesve, merrte rrugën e arratisë drejt vendeve më të sigurta. Por dokumentimi i këtyre migrameve të shqiptarëve është tepër i vonë, duke nisur vetëm nga fillimi i shek. XIV, me migrimet gjatë fushatës së fundit të Bizantit, kur një pjesë e madhe e popullsisë që mundi të shpëtonte, mërgoi drejt jugut të Ballkanit, duke u vendosur kryesisht në Peloponez dhe në ishujt grekë të Jonit, në Durrësin që zotërohej ende nga anzhuinët, dhe drejt Italisë. Kjo mund të shihet edhe si periudha e parë e emigrimeve masive që sollën lindjen e ngulimeve arvanite në Greqi dhe të atyre arbëreshe në Italinë e Jugut, që u paraprinë atyre të shek. XV për shkak të pushtimit otoman të Ballkanit. Tjetër dyndje e arbëreshëve drejt zonës joniane të Greqisë dhe kryesisht Italisë së Jugut në këtë periudhë (1368) ishte zotërimi i Durrësit nga Karl Topia¹⁰, i cili arriti të krijonte një principatë të shtrirë midis Matit dhe Shkumbinit, të shkëputur nga vasaliteti anzhuin, edhe pse ai kishte gjak francez nga e ëma. Bashkëpunëtorët dhe filoanzhuinët e Mbretërisë së Napolit morën arratinë drejt Italisë për t’i shpëtuar represionit të princit të ri shqiptar, prindërit e të cilit, Tanushin dhe Helenën nga familja mbretërore anzhuine, i kishte vrarë pabesisht mbreti i Napolit, duke u hakmarrë për martesën e tyre me dashuri pa pëlqimin e tij.

⁹ Po aty, fq.8

¹⁰ Johann Samuel Ersch, Johann Gottfried Gruber, *Allgemeine Encyclopädie der Wissenschaften und Künste*, Erste Section A-G. Hermann Brockhaus, Leipzig, 1868, f. 43.

Historia e familjes “Durazzo” - nga emigrantë në kryeministra të Gjenovës

E kësaj periudhe është edhe historia më mbresëlënëse, deri në kufijtë e legjendës, por pak e njohur te ne, e emigrimit drejt Italisë e një familjeje shqiptare, që më pas bëri emër në Republikën e Gjenovës. E ikur nga Durrësi, kjo familje mundi të zbriste në Mesinë të Sicilisë, por atje në vitin 1387¹¹ ra rob në duart e një gjenovezi, tregtar skllavërisht, i cili i çoi në Gjenovë. I pari i kësaj familjeje, të përbërë nga çifti dhe tre fëmijë¹², ishte Gjon Durrësi (Giorgio Durazzo)¹³, pas regjistrimit të të cilit me mbiemrin e italianizuar “Durazzo” njihen me këtë emër familjar deri në ditët tona. E çliruar nga skllavëria pas dy vjetësh (1389), duke u marrë me tregti, me zejen e përpunimit të lëkurëve dhe me transaksione financiare, ajo arriti që në mesin e shek. XV të ishte ndër familjet tregtare më të pasura dhe më të njohura të Republikës. Dhe do të mjaftonin pesë breza për të kaluar nga gjendja si skllavër e si emigrantë, ndër njerëzit më të fuqishëm të Gjenovës¹⁴. Më 1528 Duracot rezultojnë në regjistrin e familjeve “fisnikë të rinj” (Liber Nobilitatis Genuensis)¹⁵ të Gjenovës, ndërsa në shek. XVI janë nga familjet më të pasura që fillojnë ngjitjen në shkallët e

¹¹ Dino Puncuh, *Una famiglia di successo: i Durazzo*, në “All’ombra della Lanterna - Cinquant’anni tra archivi e biblioteche 1956-2006”, Atti della Società Ligure di Storia Patria, Nuova Serie, Vol. XLVI (CXX), Fasc. I, 2006, f. 311.

¹² Dino Puncuh, *po aty*.

¹³ Gjergji denoncoi te qeveria e Gjenovës një padrejtësi që i ishte bërë familjes së tij nga njëfarë Manuele de Valente, i cili, në bashkëpunim me të zotin e anijes që i mbarti të arratisurit, i kishte kthyer në mënyrë të paligjshme në shërbyes në portin e Mesinës dhe më pas i kishte dërguar dhe shitur në Gjenovë falë s’ëmës së këtij Valentit: Gjergjin me një djalë të Domenico Negros për 40 lira, të shoqen e tij me të birin Xhovanin te Giorgio de Lugo për 60 lira, duke mbajtur djalë e tij të tretë Nikollën në shtëpinë e vet. Doxha dhe të vjetrit e këshillit u shprehën në favor të protestës së Gjergjit dhe e njohën atë si njeri të lirë. (Puncuh, Dino, *Una famiglia di successo: i Durazzo*, në “All’ombra della Lanterna - Cinquant’anni tra archivi e biblioteche 1956-2006”, Atti della Società Ligure di Storia Patria, Nuova Serie, Vol. XLVI (CXX) Fasc. I, 2006, f. 311.

¹⁴ Angela Valenti Durazzo, *I Durazzo: da schiavi a dogi della Repubblica di Genova*, La compagnia della stampa Massetti Rodella, Roccafranca. 2004.

¹⁵ Giovanni Assereto, *I Durazzo di Palazzo Reale - Breve Storia di una grande Famiglia Patrizia*, në “Da Tintoretto a Rubens: capolavori della collezione Durazzo a cura di L. LEONCINI”, Milano, Skira, 2004, f. 25.

politikës e të diplomacisë. Pinjollë të saj në shek. XVI-XIX gjenden në postet më të larta të hierarkisë në Republikën e Gjenovës.



(Nga e majta në të djathtë) Stema e familjes Duraco (Durazzo), në vitet 1387-1576 njihet si "Durassa" (burimi: Stemmario di Giovanni Andrea Musso, 1680), Biblioteca Berio, Genova, p. 32, Pallati Durazzo, sot Pallati Mbretëror (Palazzo Reale) në rrugën Balbi, 10; ishte pronë e familjes Durazzo në vitet 1677-1824 (Wikimedia Commons)

Figura e parë e njohur e kësaj familjeje ishte Giacomo Grimaldi Durazzo, i cili u zgjodh doxhë (kryeministër) i Republikës së Gjenovës në vitet 1573-1575. Pas tij, edhe 8 kryeministra të tjerë do të dilnin nga kjo familje: Pietro Durazzo (1619-1621), Giovanni Battista Durazzo (1639-1641), Cesare Durazzo (1665-1667), Pietro Durazzo (1685-1687), Vincenzo Durazzo (1709-1711), Stefano Durazzo (1734-1736), Marcello Durazzo (1767-1769) dhe Girolamo Luigi Durazzo¹⁶ (1802-1805). Ky i fundit do të ishte i pari dhe i vetmi doxhë i Republikës së Liguries në epokën e Napoleonit¹⁷ dhe i vlerësuar shumë prej këtij, aq sa pas vdekjes në vitin 1809, zemra e tij u

¹⁶ https://it.wikipedia.org/wiki/Girolamo_Luigi_Durazzo

¹⁷ https://it.wikipedia.org/wiki/Repubblica_Ligure

dërgua në Francë dhe ruhet e konservuar në Panteonin e Parisit, ku vetë Napoleoni ishte i pranishëm në ceremoni¹⁸.

Veç nëntë kryeministrave, familja Durrësi (Durazzo) i dha Gjenovës në shek. XVI-XIX edhe shumë emra të shquar në të gjitha fushat, si: 30 senatorë, 2 kardinalë, 5 peshkopë, 16 ambasadorë, dijetarë, natyralistë, botanistë etj.

Turqit osmanë në Arbëri dhe familja Kastrioti

Por lufta e shqiptarëve arbër kundër pushtuesve të huaj në fund të shek. XIV dhe fillimin e shek. XV nuk rreshti, edhe pse aleancat midis princërve arbër ishin të brishta, të paqëndrueshme dhe grindjet e vazhdueshme midis tyre bënë që turqit apo venedikasit ta kishin më të lehtë nënshtrimin e tyre. Kështu ndodhi në betejën e Savrës në Myzeqe, në vitin 1385, ku, përveç humbjes mbeti i vrarë edhe Balsha II, i vëllai i Gjergj Balshës I. Durrësin, fare pranë Myzeqesë dhe Savrës, ku u zhvillua beteja e përgjakëshme dhe sundimtarë kishin qenë Topiajt, e kishin marrë Balshajt dy vjet më parë (1383) në një përplasje midis tyre. Karl Topia, siç bënë edhe feudalë të tjerë shqiptarë, që, për të mbrojtur pushtetin e tyre, thërritnin në ndihmë mercenarë të huaj, kërkoi në vitin 1386 ndihmën e ushtrive turke të sulltan Muratit I për të rimarrë Durrësin e pushtuar nga Balshajt më 1383¹⁹ dhe për të qenë i sigurt nga sulmet serbe dhe pretendimet bizantine. Turqit iu përgjigjën thirrjes së tij dhe, me ndihmën e tyre, Karl Topia i theu Balshajt, duke u marrë jo vetëm Durrësin, po edhe Krujën e Beratit²⁰. Pas vdekjes së Karl Topisë në vitin 1888, sundimtar i Durrësit u bë i vëllai, Gjergj Topia, i cili ua dorëzoi paqësisht principatën venecianëve në vitin 1392, duke u bërë vasal i tyre

¹⁸ Edouard Leduc, *Dictionnaire du Panthéon (de Paris)*, Editions Publibook, 2013, f. 103.

¹⁹ Edwin E. Jacques, *The Albanians: An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present*, McFarland, London, 2009, f. 169.

²⁰ Johann Wilhelm Zinkeisen, *Geschichte des osmanischen Reiches in Europa: Urgeschichte und Wachstum des Reiches bis zum Jahr 1453*, Erster Theil, Friedrich Perthes, Hamburg, 1840, f. 764.

kundrejt një pagese vjetore dhe ndihmave me karakter kryesisht ushtarak. Mirëpo turqit, atje ku vinin këmbën, nuk ktheheshin më mbrapsht, po depërtonin në thellësi të vendit, duke zgjeruar sundimin e tyre e duke kthyer në vasalë të sulltanit shumë prej krerëve ballkanas. Por ajo që i anoi përfundimisht balancat në favor të turqve osmanlinj, ishte beteja e Kosovës e vitit 1389²¹, që përfundoi me thyerjen e aleancës së krishterë ballkanase dhe vrasjen e të dy udhëheqësve kryekomandantë të ushtrive, Sulltan Muratit I²² dhe Carit të Serbisë, Lllazar Hrebeljanović²³, duke i hapur rrugën përfundimisht pushtimit turk të Ballkanit.

Ushtria ballkanase, si rrallëherë e bashkuar përbëhej prej serbësh, bullgarësh, boshnjakësh, shqiptarësh, vlllehësh, polakësh dhe hungarezësh dhe në këshillin e luftës bënë pjesë edhe disa prijësa arbër, si Gjergj Balsha II, Teodor Muzaka II, Gjergj Kastrioti (një stërgjysh i Skënderbeut), si dhe disa kapedanë të tjerë shqiptarë. Midis prijësve të vrarë ishte edhe Teodor Muzaka, bashkë me shumë luftëtarë arbër²⁴. Kjo humbje e madhe solli edhe dobësimin e principatave arbërore, pjesa më e madhe e të cilave u bënë vasale të Perandorisë Osmane. Një prej tyre, nga më të fuqishmet e kohës dhe me shtrirje të gjerë të zotërimeve të saj, ishte edhe principata e Kastriotëve, në krye të së cilës ishte Gjon Kastrioti, i ati i Gjergjit, Skënderbeut të ardhshëm. Gjon Kastrioti trashëgoi nga i ati vetëm dy fshatra të vogla pranë lumit Drin, Sinjën dhe Gardhin e Poshtëm, por më pas zaptoi Matin, Dibrën dhe e zgjeroi principatën nga Prizreni deri në bregdetin Adriatik, në afërsi të Ishmit, midis Durrësit dhe Shën Gjinit në Lezhë. Në vitin 1395 mori edhe Krujën dhe u bë zot i saj²⁵. Nga martesë me Vojsavën, të bijën e kryezotit

²¹ Peter Dragičević, *Montenegro*, Lonely Planet, Torino, 2013, f. 19.

²² John H. Kautsky, *The Politics of Aristocratic Empires*, Routledge, Abingdon, 2017, f. 211.

²³ John Van Antwerp Fine, *The Late Medieval Balkans: A Critical Survey from the Late Twelfth Century*, University of Michigan Press, 1987, f. 410.

²⁴ *Po aty*, fq.10.

²⁵ *Po aty*, fq.17.

të Pollogut, në afërsi të Tetovës (sot në Maqedoninë e Veriut), edhe ky territor hynte nën influencën e Kastriotëve²⁶, Gjon Kastrioti pati nëntë fëmijë, katër djem Stanishi, Reposhi, Kostandini dhe Gjergji, më i vogli dhe pesë vajza. Katër nga pesë vajzat e tij (Mara, Vljaka, Angjelina dhe Jella) i martoi me kryezotë të njohur të kohës me të cilët forcoi edhe aleancat ushtarake në lufrat kundër armiqve të përbashkët: Stefan Çernoviçin e Malit të Zi, Gjon Muzakën, Vladan Arianitin, të vëllanë e Gjergj Arianitit të Kaninës, si dhe Pal Stres Balshën. Vajza e pesë, Mamica, ishte e vogël dhe do të martohej pas vdekjes së Gjonit me Muzakë Topinë, nën kujdesin e Skënderbeut pas kthimit të tij në Krujë. Ekuilibrat e tij politikë në marrëdhëniet me turqit, Venedikun, Raguzën dhe sundimtarët e tjerë vendës e kishin çuar atë në zgjerimin e territoreve të principatës së tij dhe në kontrollin e rrugëve të kalimit në pjesën më të madhe të Ballkanit Jugperëndimor, sidomos pas disfatës së madhe në Ankara të ushtrive turke nga mongolët në vitin 1402²⁷. Por, pasi e rimorën veten dhe zgjidhën konfliktet e brendshme, osmanët iu drejtuan përsëri Ballkanit, duke nënshtruar principatat arbë, midis tyre edhe Gjon Kastriotin, i cili u detyrua të dërgonte katër djemtë e tij, midis të cilëve edhe Gjergjin 9-vjeçar, peng në oborrin e sulltanit, në shenjë garancie për vasalitetin e tij²⁸.

Që nga vitet e para të shek. XV dhe deri në vitet 1430 jeta e Gjon Kastriotit shkoi në luftë kundër turqëve, ngrinte krye kur ndihej i fortë dhe i nënshtrohej kushteve të sulltanit kur thyhej në fushën e betejës. Kështu ndodhi në përballjet me pashallarët që dërgonte Sulltani në vitet 1410, 1416, 1428 dhe 1430. Pas këtij viti turqit e kishin pushtuar pothuaj të gjithë Arbërinë,

²⁶ *Po aty*, fq.18.

²⁷ John Van Antwerp Fine, *po aty*, f. 422.

²⁸ Heinrich Kretschmayr, *Geschichte Von Venedig, Zweiter Band: Die Blüte*, Salwasser Verlag, 2012, f. 375.